MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DEGËN DOGANORE BERAT

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Degën Doganore Berat me objekt "Mbi realizimin e të ardhurave doganore dhe zbatimin e legjislacionit doganor" dhe për auditimin e insitituciont për vitin 2010 dhe 2011. Masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.75, datë 18/05/2012.
Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 117/5, datë 18/05/2012 dërguar Z. Besnik Gjevori, Kryetar i Degës Doganore Bllatë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. Masa organizative

1. Autoriteti doganor kompetent të analizojë me të gjithë stafin Raportin Përfundimtar të Auditimit në të cilin janë paraqitur rast pas rasti shkeljet e konstatuara, njëkohësisht të përgatisë një program pune të veçantë me persona përgjegjës, për zbatimin e rekomandimeve të dërguara, bashkëlidhur këtij raporti.

Menjëherë

2. Të merren të gjitha hapat ligjorë, për njoftimin e subjekteve debitor sapo të saktësohet dhe kontabilizohet detyrimi i papaguar, të përfundojnë në kohë të gjitha procedurat ligjore deri në arkëtimin e plotë të borxhit, në mënyrë të veçantë të arkëtohet ajo pjesë e borxhit e cila është mbështetur me Urdhra Ekzekutimi nga Autoritetet Gjyqësore.

Vazhdimisht

3. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të merren masa të plota ligjore, organizative dhe teknike për kontrollin dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të subjekteve të autorizuar për përdorimin e regjimeve ekonomike, kryesisht regjimin e përpunimit aktiv.

Vazhdimisht

4. Dega e Doganës Berat të ushtrojë përgjegjësinë e saj ligjore për të nxjerrë vendime sa më të sakta, lidhur me zbatimin e sanksioneve për shkeljet doganore të konstatuara nga kontrolli i brendshëm, kontrolli aposteriori, hetimet doganore, dhe kontrollet e jashtme për zonën që ai mbulon. Gjithashtu, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike në DPD, të saktësojë dhe kontabilizojë sanksionet e pa zbatuara në 12 vendimet e marra nga autoriteti doganor për mos shlyerje të TVSH-së së shtyrë në afat, paraqitur në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

B. Masa zhdëmtimi

1. Të saktësohen, kontabilizohen dhe të ndiqen procedurat ligjore për detyrime doganore të rezultuara dhe të pa llogaritura në zhdoganinim e artikujve të ndryshëm për pesë subjekte privat me një vlerë totale dëmi prej 891,772 lekë.

Deri më datë 30.06.2012

2. Të saktësohen, kontabilizohen dhe të ndiqen në rrugë ligjore penalitetet për moszbatimin e procedurave ligjore të regjimit të lejimit të përkohshëm me përjashtim të pjesshëm të detyrimeve doganore të tre subjekteve privatë me një vlerë totale dëmi prej 2,080,115 lekë.

Deri më datë 30.06.2012

C. Masa disiplinore

Në zbatim të Kreut 6 "Shkeljet dhe masat disiplinore", nenit 16, pika 16.1 germa "a" të Vendimit të K. M nr. 205 datë 13/04/1999 "Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganorë", si dhe mbështetur në nenin 25 të ligjit nr. 8549, datë 11/11/1999 "Statusi i nëpunësit civil" dhe pikën 1 e 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 306, datë 13/06/2000 "Për disiplinën në shërbimin civil", kërkojmë të fillojnë proçedurat për dhënien e masës disiplinore:

1. "Largim nga shërbimi civil", neni 25, pika 3, germa d, për një punonjës, për për moszbatim të ligjit nr. 8449, datë 27/01/1999 "Kodi Doganor", neni 273, pika 2 , për dy raste me përjashtim të pjesshëm të detyrimeve doganore të subjekteve dy subjeketev privatë si për moszbatim të ligjit nr. 8449,

datë 27/01/1999 “Kodi Doganor”, neni 245, pikat 1,2,3 dhe 4 dhe neni 289 , pika 2, për një rast me përjashtim të pjesshëm të detyrimeve doganore të një subjekti tjetër privat.

2. “Pezullimi nga e drejta e ngritjes në detyrë, për një periudhë 6 mujore”, neni 25, pika 3, germa c, për dy punonjës, për moszbatim të ligjit nr. 8449, datë 27/01/1999 “Kodi Doganor” nenet 11, 23 dhe 34-39. dhe të kërkesave të VKM nr. 205, datë 13/04/1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” si dhe për moszbatim të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 25. datë 30/11/2007 “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhëna të disponueshme, si dhe zhdoganimin e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit të tyre”, dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nr. 1, datë 25/01/2006 “Mbi procedurat e shqyrtimit të Vlerës Doganore”, pikat 1,2,3 dhe 4 si dhe seksioni II, pikat 11.4 dhe 11.5.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit z. Neritan Matoshi, përgjegjës grupi, z. Përparim Gjuzi dhe anëtar, z. Jeras Poçi. Më tej u shqyrtua nga Kryeauditues i Departamentit z. Kristaq Gjurgjaj, Drejtori i Departamentit z. Kristaq Gjurgjaj dhe Drejtori i Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë z. Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm z. Robert Gjini.